

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
 PROKURORI I SHTETIT - DRŽAVNI TUŽILAC  
 Zyrë e Kryeprokurorit të Shtetit  
 Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca

Pranuar - 7 -03- 2018 Primljeno

Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Datumi prijave	Nivëzimi i pranimit Priznani primaoce

KMLK-13/17

*B. B. B.*

KML.nr.7/2017

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Rasim Rasimi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj procesmbajtës, në çështjen kundërvajtëse kundër të pandehurit Bekim Thaqi, nga Glogoci, për shkak të kundërvajtjes nga neni 25 të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3, nenit 10 dhe 14 të Ligjit nr.03/L-153, për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet e Kosovës 2003/3, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës KA.nr.255/2017 datë 11.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27 Shkurt 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës KA.nr.255/2017 datë 11.04.2017, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Glogoc K.nr.8788/2016 datë 06.02.2017, i pandehuri Bekim Thaqi, është shpallur përgjegjës për shkak të kundërvajtjes nga neni 25 të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3, nenit 10 dhe 14 të Ligjit nr.03/L-153 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3 e sanksionuar me nenin 36 par.3 të Ligjit për Pyjet e Kosovës, 2003/3 përkatësisht nenit 14 të Ligjit nr.03/L-153, dhe është ndëshkuar me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilën është i obliguar që të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi e në të kundërtën do të merret aktvendim i ri në vështrim të nënti 271 të Ligjit mbi Kundërvajtje ku do të bëhet arkëtimi me dhunë i gjobës. Është shqiptuar edhe masa mbrojtëse e konfiskimit të masës drunore në sasi prej 0.50 m<sup>3</sup>, është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 5 €.



Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin KA.nr.255/2017 datë 11.04.2017, ka hedh poshtë ankesën e ushtruar nga Drejtorati i Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë për shkak se ankesa është e pasafatshme.

Kundër këtij aktgjykimi, Prokurori i Shtetit të Kosovës ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nën par.1.2, 1.3 dhe par.3 të KPPK, me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Janë të bazuara pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore lidhur me afatin e paraqitjes së ankesës respektivisht llogaritjen e afatit.

Vlen të theksohet se në rastin konkret afati i ankesës kundër aktvendimit të kundërshtuar është 8 ditë. Aktvendimin e shkallës së parë, pala e dëmtuar- Drejtorati Qëndror i Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë, e ka pranuar me 28.02.2017 kurse data e fundit e paraqitjes së ankesës ka qenë 8 mars 2017.

Nga shkresat e çështjes rezulton se ankesa e palës së dëmtuar është dorëzuar në Gjykatë Themelore në Prishtinë-Dega në Gillogoc, më 10 mars 2017 gjë që vërtetohet nga vula e pranimit të dërgesës, e vendosur në këndin e sipërm të djathtë të ankesës ku qëndron data, ndërsa nuk ka konstatim nëse dërgesa ka arritur përmes postës apo është dorëzuar në gjykatë në mënyrë tjetër.

Për të vërtetuar thëniet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, lidhur me afatshmërinë e ankesës, kjo gjykatë ka siguruar raportin-pasqyrën e pranimit të dërgesave të porositura me 6 mars 2017 në Postë në Prishtinë. Nga ky raport rezulton se nën numrin rendor 02 është evidentuar dërgesa e adresuar për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, me numër të referencës 77/2017. Nga ana tjetër nga shkresa e Drejtoratit Qëndror i Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë, në aktin përcjellës të ankesës së adresuar, qëndron numri i referencës DQIPGJ-77/17 datë 01.03.2017 e që përputhet me numrin e referencës të dorëzuar në postë me datë 06.03.2017, e që nga kjo rezulton se ankesa është dorëzuar brenda afatit ligjor.

Dispozita e nenit 445 par. 3 të KPPK parashikon se kur deklarata dërgohet nëpërmjet postës, postës rekomande apo telegramit ose ndonjë mjet tjetër, dita e



postimit ose dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit për personin që i është dërguar. Në rastin konkret siç u elaborua më sipër ankesa është dorëzuar më 6.3.2017 dhe rrjedhimisht është e afatshme meqë data e fundit të dorëzimit të ankesës do të ishte 8 mars 2017.

Në rivendosje gjykata e shkallës së dytë duhet të merr ankesën si të afatshme dhe të merr një vendim të drejtë dhe bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
KML.nr. 7/2017 më 27 shkurt 2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj



Kryetare e kolegjit,  
Nasrin Lushta

REPUBLIKA E KOSOVËS  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË  
KOPJË E KOPJËS E VËRTETON  
OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtor i autorizuar  
Otvorščeni radnik